




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-7775/23 datë: 22.03.2023



Npi – 01/110 datë: 28.03.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 28.03.2023 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 28.03.2023 (e martë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24.02.2023,
2. Propozim – Vendim për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Shtimes,
3. Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24.02.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit miratoi, Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KPF-së, e mbajtur më 24.02.2023.**

Pika 2

Propozim – Vendim për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dha një sqarim të shkurtër të Rregullores që është miratuar me datë 28.11.2022 në Shqipëri. Ka ndryshime sepse zgjidhjet do të organizohen nëpër zona, për dallim nga e kaluara. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, sa i përket këtij komisioni, kryetarët e mëparshëm të fshatrave e lagjeve urbane pak kanë qenë produktiv, sepse pak a shumë i ka pas fajet ekzekutivi i Komunës, për arsye se nuk ka bërë asgjë për me i futë në pagesë, kështu që ka pas ankesa të shumta për një pages sado e vogël të jetë. Unë mendoj se është mirë që të thirren kryetarët e vjetër në mbledhje. Unë jam për me i rekomanduar Kuvendit për me zgjedhë këtë komision.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem që ti japim rekomandim Kuvendit. Është mirë që përfaqësuesi i OJQ-së të vjen në mbledhjen e Kuvendit, dhe të votohet në pako. Propozoj që anëtar i

komisionit nga ekzekutivi të jetë jo politik, ndërsa në fshat zgjidhet aty për aty. Anëtarin nga ekzekutivi e propozon Administrata.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E thash edhe unë se anëtarin nga ekzekutivi e propozon Administrata, po ashtu duhet ta plotësojmë edhe kuotën gjinore.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për këshillat e fshatrave sipas këtij qelësi:**

- Nga Kuvendi të zgjidhen 4 anëtarë,
- Nga Shoqëria Civile të vjen propozimi në Kuvend dhe të votohet përbërja komplet,
- Përfaqësuesi nga Ekzekutivi të vjen nga Administrata me një kandidat jo politik (pa pozita politike),
- Të plotësohet kuota gjinore,
- Përfaqësuesi i fshatit ose lagjes urbane, zgjidhet aty për aty në mbledhje.

Pika 3

Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Unë do të jem i qartë dhe i shkurtër, mbi bazën e pikave që janë trajtuar. Materialin e keni pranuar për këtë pikë me kohë. (shih dokumentin). Në vazhdim ky ndaras e lexoi materialin në pikat kryesore. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë jam i interesuar me ditë pak më shumë për rritjen e të hyrave?

z.Bujar Ferati, ZKF; Këtu kemi të bëjmë vetëm me të hyrat vetanake, aty e kemi një kufi (tavan) i cili po u tejkalua atëherë mjetet nuk mund të shfrytëzohen, prandaj jemi të detyruar që këto mjete ti bartim në vitin tjetër, tejkalmimi në këtë rast është për 243,192€. Ndërsa 108,000€ janë të pa shpenzuara nga vitet paraprake 2021.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dmth. kemi tepricë nga viti 2021 dhe 2022, pyetja ime është teprica te Subvencionet, a paraqiten edhe ato si tepricë apo jo?

z.Bujar Ferati, ZKF; Jo këtu te këto mjete nuk kemi të bëjmë me subvencione. Këto janë shqetësime edhe tonat nëse nuk realizohen, por ajo është temë tjetër.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për sqarimet, normalisht në mbledhje është dashur me qenë edhe drejtorët të cilët po i kërkojnë këto mjete 3-4 drejtorë sa janë. Psh. 60.000€ janë kërkuar për renovim të shkollave, ne po duam me ditë pak më saktësisht se për cilat shkolla po bëhet fjalë për këto mjete. Te subvencionet psh. drejtori me na sqaruar se pse nuk janë shpenzuar 30.000€ të subvencioneve. Unë do të abstenoj për arsye se drejtorët duhet me Ardhur dhe me na dhënë sqarime.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, po lidhem me fjalën e Kryesuesit, kështu që unë do të jem "Kundër" për arsye se janë ndarë vetëm 5000€ për kulturë, ndërkaq që drejtoresha ka thënë se do ti ndajmë 50.000€. Kështu pra do të them edhe në Kuvend. Bartja është shumë e vogël 5000€ ndërkaq që ka dhënë premtime në fushatë.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, vota ime do të jetë "Kundër" sepse te shërbimet sociale janë 20.000€ për mallra dhe shërbime, e unë mendoj se QPS-së më shumë i duhet një veturë se sa mallra dhe shërbime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve.

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota "Për", me 2 vota "Kundër dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual 2023, si dhe rritjen e kufirit të hyrave vetanake, me propozimin që në mbledhjen e Kuvendit më 30.03.2023 të jenë prezent drejtorët dhe të japin sqarime për arsyet, pse i kanë kërkuar mjetet financiare.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi diskutime të tjera nuk kishte mbledhja e përfundoi në ora 11:10h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi